

**AKT THEMELIMI DHE STATUT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"FinanceTeams" Sh.p.k.**

**ESTABLISHMENT ACT AND STATUTE  
OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY  
"FinanceTeams" Sh.p.k.**

**KREU I  
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1:  
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 7850, dt. 29.07.1994 "Kodi Civil i RSH", i ndryshuar, në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", më datë 21-03-2024 kemi themeluar Shoqërinë me emërtimin "**FinanceTeams**" Sh.p.k., në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

Themeluesi i shoqërisë është:

- **FinanceTeams B.V**, shoqëri e së drejtës tregtare Holandeze, regjistruar pranë Dhomës së Tregtisë së Vendeve të Ulëta, më 13 Gusht 2021, me numër regjistrimi 862948022, me seli në bashkinë Heerlen.

**CHAPTER I  
ESTABLISHMENT DATE, NAME, OBJECT, DURATION, RESIDENCE**

**Article 1:  
Establishment date, Name and Founders**

*Based on the Constitution of the Republic of Albania, Law No. 7850, dt. 29.07.1994 "Civil Code of Republic of Albania", amended, Law No. 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies", amended, as well as Law No. 131/2015 "For the National Business Center", on the date 21-03-2024 we established the Company with the name "**FinanceTeams**" Ltd., in the form of a limited liability company, whose activity is regulated by the Albanian Legislation in force and by this Statute.*

The founder of the company is:

- **FinanceTeams B.V**, a company under Dutch commercial law, registered with the Chamber of Commerce of the Netherlands, on August 13, 2021, with registration number 862948022, with headquarters in the municipality of Heerlen.

**Neni 2:  
Objekti**

- 2.1 Shoqëria ka për objekt aktivitetin e mëposhtëm:
- a) kryerjen e aktiviteteve holding, administrimit dhe menaxhimit;
  - b) ofrimin e shërbimeve të menaxhimit, konsulencës dhe trajnimit;
  - c) ofrimin e konsulencës në fushën ekonomike, juridike, tregtare dhe/ose financiare, si dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve në fushën e organizimit dhe konsulencës, dhe në këtë mënyrë ofrimin e shërbimeve dhe konsulencës në fushën e menaxhimit dhe ofrimin të administrimit (i përkohshëm) dhe menaxhimit të projekteve, të gjitha në kuptimin më të gjerë;

- d) investimin në aksione, letra me vlerë, prona të regjistruara, pretendime borxhi, fonde dhe aktive të tjera, si dhe blerjen, nxjerrjen jashtë përdorimit, shfrytëzimin dhe administrimin e këtyre objekteve investuese ose të të drejtave mbi to;
- e) shfrytëzimin, blerjen dhe tjetërsimin e sendeve (të drejtat pronësore dhe tregtare) duke përfshirë shprehimisht patentat, licencat, know-how dhe markat tregtare; dhënien dhe marrjen me qira, blerjen dhe shitjen si dhe tregtinë me prona (të paluajtshme);
- f) krijimin dhe blerjen e, pjesëmarrjen në, bashkëpunimin me, menaxhimin dhe financimin e sipërmarrjeve të tjera, në çfarëdo forme ligjore ato qofshin;
- g) dhënien dhe hyrjen në kredi, administrimin dhe zotërimin e pronave të paluajtshme dhe ofrimi i garancive, përfshirë edhe për borxhet e të tjerëve dhe gjithashtu të gjitha qëllimet e tjera në fushën financiare, administrative, ekonomike, tregtare dhe industriale;
- h) kryerja e gjithçkaje që lidhet me sa më sipër ose mund të jetë e favorshme për këtë, të gjitha në kuptimin më të gjerë.

**Article 2:  
Object**

*2.1 The company has the following activity as its object:*

- a) performing holding, administration and management activities;*
- b) provision of management, consultancy and training services;*
- c) providing consultancy in the economic, legal, commercial and/or financial field, as well as performing all activities in the field of organization and consultancy, and thus providing services and consultancy in the field of management and providing administration (temporary) and project management, all in the broadest sense;*
- d) investing in stock-market, securities, registered properties, debt claims, funds and other assets, as well as the purchase, disposal, use and administration of these investment objects or rights over them;*
- e) the use, purchase and alienation of items (property and commercial rights) including expressly patents, licenses, know-how and trademarks; giving and receiving rent, buying and selling as well as trading in property (real estate);*
- f) creation and acquisition of, participation in, cooperation with, management and financing of other enterprises, in whatever legal form they may be;*
- g) granting and entering into loans, administration and possession of immovable properties and providing guarantees, including for the debts of others and also all other purposes in the financial, administrative, economic, commercial and industrial fields;*
- h) doing everything related to the above or may be conducive to it, all in the broadest sense.*

**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Article 3:  
Duration**

3.1 *The duration of the company is indefinite.*

**Neni 4:  
Selia**

- i. Shoqëria e ka selinë në: Rruga "Ismail Qemali", nr. Ap. 19, Tiranë.
- ii. Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Article 4:  
Residence**

*i. The company's residence will be at: "Ismail Qemali" Street, no. App. 19, Tirana.*

ii. By decision of the administrative body, the company can open branches or representative offices inside and outside the territory of Albania.

**KREU II  
KAPITALI**

**CHAPTER II  
CAPITAL**

**Neni 5  
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 (Njëqind) Lekë dhe është i ndarë në 1 (Një) kuotë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtëm:
  - a) Ortaku themelues **FinanceTeams B.V.**, zotërues i 1 (Një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 (Njëqind) Lekë, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Article 5  
Initial Capital**

- 1) *The initial capital of the company is 100 (One Hundred) Lek and is divided into 1 (One) quota. The founder's participation in the capital of the company is in accordance with his following contribution:
  - a) The Founding Partner **FinanceTeams B.V.**, owner of 1 (One) quota with a total value of 100 (One Hundred) Lek, which constitutes 100% of the company's share capital.*
- 2) *The partner's contribution can be in cash or in kind (movable/immovable assets or rights).*

**Neni 6:  
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga Asambleja e Ortakëve e një eksperti të autorizuar për këto kontribute.
- 2) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 3) Në të gjitha rastet zvogëlimi e prek ortakun në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqëson.

**Article 6:  
Capital increase and decrease**

- 1) *The capital of the company can be increased through the signature of parts of the basic capital for cash contributions and through contributions in kind, through the appointment by the Assembly of Shareholders of an expert authorized for these contributions.*
- 2) *The reduction of the capital is allowed by the shareholders' assembly, which takes a decision under the same conditions that are required for the change of the statute.*
- 3) *In all cases, the reduction affects the partner to the same extent to the parts of the capital it represents.*

**Neni 7  
Transferimi i kapitalit**

- 1) Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - i. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - ii. shitblerjes;
  - iii. trashëgimisë;
  - iv. dhurimit;
  - v. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

- 3) Pjesët e kapitalit themelues janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### **Article 7**

##### **Transfer of Capital**

- 1) *The shares of the company's capital and the rights derived from them can be acquired or transferred through:*
- i. contribution to the capital of the company;*
  - ii. sale and purchase;*
  - iii. inheritance;*
  - iv. donation;*
  - v. any other way provided by law.*
- 2) *Shares of the initial capital are freely transferable between partners, unless otherwise provided in the statute.*

#### **KREU III**

##### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

##### **CHAPTER III**

##### **DECISION-MAKING AND MANAGING BODIES**

#### **Neni 8**

##### **Organi Vendimmarrës**

- 1) Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprjë si përfaqësues i ortakëve në asamblesë e përgjithshme.
- 6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Article 8**

##### **Decision-Making Body**

- 1) *The Assembly of Shareholders is the sole decision-making body of the company.*
- 2) *The Assembly of Shareholders is the only decision-making body of the company that approves any changes to the statute according to the modalities defined in the law.*
- 3) *The General Assembly of Shareholders is responsible for making decisions for the company on the following issues:*
  - a) determining the commercial policies of the company;*
  - b) changes to the statute;*

- c) *appointment and dismissal of administrators;*
  - d) *appointment and dismissal of liquidators and authorized accounting experts;*
  - e) *determining the rewards for the persons mentioned in the letters "c" and "ç" of this point;*
  - f) *supervision of the implementation of commercial policies by administrators, including the preparation of annual financial statements and activity progress reports;*
  - g) *approval of annual financial statements and activity progress reports;*
  - h) *capital increase and decrease;*
  - i) *allocation of quotas and their cancellation;*
  - j) *representing the company in court and in other proceedings against administrators;*
  - k) *reorganization and dissolution of the company;*
  - l) *approval of the procedural rules of assembly meetings;*
  - m) *other issues provided by law or statute.*
- 4) *The shareholders may be represented in the general assembly, based on an authorization from another partner or a third person.*
  - 5) *The administrator of the company cannot function as a representative of the shareholders in a general company.*
  - 6) *Authorization can only be given for a general meeting, which will also have subsequent meetings with the same agenda.*

#### **Neni 9**

#### **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

- 1) *Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji dhe nga ky statut, sa herë që është e nevojshme mbledhja e saj për të mbrojtur interesat e shoqërisë.*
  - 2) *Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga ortaku i vetëm, që zotëron 100% të votës në Asamblienë e Përgjithshme në respektim të parashikimeve të neneve 83 dhe 84 të ligjit Nr. 9901, datë 14.01.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".*
  - 3) *Ortaku do të njoftohet për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me anë të një letre të porositur (rekomande) ose postës elektronike.*
- Ortakët janë të detyruar që të depozitojnë me shkrim pranë administratorit të shoqërisë adresën në të cilën do t'i dërgohet njoftimi nga Shoqëria me anë të letrës së porositur (rekomande), si dhe adresën e postës elektronike ku do ti dërgohet njoftimi. Dërgimi i njoftimit në këto adresa do të konsiderohet si njoftim i kryer rregullisht.*
- 4) *Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës.*
  - 5) *Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas mënyrës së mësipërme ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortaku i vetëm/ortakët e shoqërisë janë të pranishëm në mbledhje ose të përfaqësuar dhe janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë së thirrjes.*
  - 6) *Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në zyrën qendrore (selinë) të shoqërisë ose në një vend tjetër të përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.*

#### **Article 9**

#### **Meeting of the General Assembly**

- 1) *The general assembly is convened in the cases determined by the law and this statute, whenever its meeting is necessary to protect the company's interests.*
  - 2) *The meeting of the General Assembly is called by the Administrator or by the sole shareholder/shareholders, who owns 100% of the vote in the General Assembly in compliance with the provisions of Articles 83 and 84 of Law No. 9901, dated 14.01.2008 "For Entrepreneurs and Commercial Companies".*
  - 3) *The shareholder will be notified of the meeting of the General Assembly by means of a postal letter (registered) or electronic mail.*
- The shareholders are obliged to deposit in writing with the administrator of the company the address to which the notification will be sent by the Company by the postal letter (registered), as well as the e-mail address to which the notification will be sent. The sending of the notice to these addresses will be considered as a regularly performed notice.*
- 4) *The meeting notification must contain the place, date, time of the meeting, and the agenda.*
  - 5) *When the General Assembly has not been called according to the above procedure, it can make valid decisions only if the sole shareholder(s) of the company are present at the meeting or represented and agree to make decisions, regardless of the irregularity of the call.*

- 6) *The meeting of the General Assembly can be held at the residency office of the company or in another place determined by the decision of the General Assembly.*

**Neni 10**  
**Kuorumi**

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shpresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Article 10**  
**Quorum**

- 1) *In the case of taking decisions that require a simple majority, the general assembly can take valid decisions only if the shareholders with the right to vote participate, owning more than 30 percent of the quotas.*
- 2) *In the case when the general assembly has to decide on issues that require a qualified majority according to Article 87 of the Law "On Entrepreneurs and Commercial Companies", it can make valid decisions only if the shareholders who own more than half of the total number of votes, are present in person, vote by paper or electronic means, according to the provisions of point 3 of article 88 of this law.*
- 3) *If the general assembly cannot be convened due to the lack of quorum mentioned above, the assembly is convened again no later than 30 days, with the same agenda.*

**Neni 11**  
**Marrja e vendimeve**

- 1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ocursës së veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**Article 11**  
**Decision Making**

- 1) *The general assembly decides with three-quarters of the votes of the capital owners, of the participating shareholders, on the change of the statute, the increase or decrease of the registered capital, the distribution of profits, the reorganization and the dissolution of the company.*
- 2) *The general assembly decides with the majority of votes of the participating shareholders, on other issues such as:*
  - i. *determining the commercial policies of the company;*
  - ii. *appointment and dismissal of administrators;*



- iii. *appointment and dismissal of liquidators and authorized accounting experts;*
  - iv. *determination of rewards;*
  - v. *supervision of the implementation of commercial policies by administrators, including the preparation of annual financial statements and activity progress reports;*
  - vi. *representing the company in court and in other proceedings against administrators;*
  - vii. *approval of the procedural rules of assembly meetings;*
- 3) *Any changes to the statute must be filed with the QKB to reflect the changes in the company file.*

**Neni 12**  
**Përrjashtimi nga e drejta e votës**

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**Article 12**  
**Exemption from the right to vote**

- 1) *The shareholder cannot exercise the right to vote if the general assembly takes a decision on:*
  - a) *evaluation of his activity;*
  - b) *extinguishing any obligation under his charge;*
  - c) *filing a lawsuit against him by the company;*
  - d) *the granting or not of new benefits.*
- 2) *When the partner is represented by an authorized representative, the authorized representative is considered to be in the same conflict of interest as the partner, whom he represents.*

**Neni 13**  
**Administrimi**

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet **Z. Thomas Johannes Petrus Hubert Van Wersch**, me shtetësi holandeze, lindur më 04.10.1990, në Heerlen, identifikuar me anë të pasaportës me numër NUK4617J4, me banim në 6287 BD Eys, bashkia Gulpen-Wittem, Leeuwcrijkstraat 3, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.
- 2) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Article 13**  
**Administration**

- 1) *The administrator of the company is appointed Mr. Thomas Johannes Petrus Hubert Van Wersch, with Dutch citizenship, born on 04.10.1990, in Heerlen, identified by passport number NUK4617J4, residing at 6287 BD Eys, Gulpen-Wittem municipality, Leeuwerikstraat 3, with a term of appointment of 5 years, starting from the date of appointment.*
- 2) *The general assembly appoints one or more natural persons as administrators of the company. The term of appointment is 5 years, with the right of renewal. The appointment of administrators produces effects after registration with the National Business Center.*

**Neni 14**  
**Kompetencat e Administratorit/ëve**

- 1) Administratori/ët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratori/ët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbëimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**Article 14**  
**Powers of the Administrator/s**

- 1) *The administrator/s have the right and are obliged to:*
- a) *perform all actions of the administration of the commercial activity of the company, implementing the commercial policies, decided by the general assembly;*
  - b) *represent the commercial company;*
  - c) *take care of the correct and orderly keeping of the company's documents and accounting books;*
  - d) *prepare and sign the annual balance sheet, the consolidated balance sheet and the activity progress report and, together with the proposals for the distribution of profits, present these documents to the general assembly for approval;*
  - e) *create a timely warning system for circumstances that threaten the smooth running of the activity and the existence of the company;*
  - f) *perform the registrations and send the mandatory data of the company, as provided for in the law on the National Business Center;*
  - g) *report before the general assembly regarding the implementation of commercial policies and the realization of special actions of special importance for the activity of the commercial company;*
  - h) *perform other duties defined in the law and in the statute.*
- 2) *The administrator/s are obliged to call the General Assembly, in cases where:*
- a) *according to the annual balance sheet or interim financial reports, it results or there is a risk that the assets of the company do not cover the liabilities to be demanded within the next 3 months.*
  - b) *the company proposes to sell or otherwise dispose of assets, which have a value higher than 5 percent of the company's assets, which results in the last certified financial statements.*
  - c) *the company, within the first 2 years after its registration, proposes to buy from a partner assets that have a value higher than 5 percent of the company's assets, which results in the last certified financial statements.*
- 3) *If the general assembly appoints more than one administrator, they jointly administer the company.*
- 4) *The general assembly may dismiss the administrator at any time by a simple majority. Lawsuits related to the remuneration of the administrator, based on contractual relations with the company, are regulated according to the legal provisions in force.*



**Neni 15**  
**Përgjegjësitë e Administratorit**

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2) Pasoja e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
- 6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - e) jep kredi.
- 7) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- 8) Padiësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**Article 15**  
**Responsibilities of the Administrator**

- 1) *The administrator is responsible individually, to the company or to third parties, for violations of laws, for violations of the statute, or for faults committed during the administration of the company.*
- 2) *The consequences of agreements not approved by the assembly that bring harm to the company, are charged to the administrator and the shareholder who made the agreement, to bear the consequences individually or jointly according to the relevant case.*
- 3) *In addition to what is provided in the general provisions of the obligation of loyalty, according to articles 14, 15, 17 and 18 of the law " On Entrepreneurs and Commercial Companies ", the administrator is obliged:*

- a) to perform his duties defined in the law and in the statute in good faith and in the best interest of the company as a whole, paying special attention to the impact of the company's activity on the environment;
  - b) to exercise the powers recognized in the law and in the statute only for the achievement of the goals defined in these provisions;
  - c) to assess with responsibility the issues for which a decision is made;
  - d) to prevent and avoid cases of conflict, present or potential, of personal interests with those of society;
  - e) exercise his duties with the necessary professionalism and care.
- 4) The administrator, during the performance of his duties, is responsible to the company for any action or omission, which is reasonably related to the goals of the commercial company, except for cases where, based on the investigation and evaluation of the relevant information, the action or the omission was committed in good faith.
- 5) If the administrator acts contrary to the duties and violates the professional standards, according to points 1 and 2 of this article, he is obliged to compensate the company for the damages resulting from the violation, as well as to transfer any personal profit that they or the persons related to them have carried out these irregular actions. The administrator has the burden of proof to prove the performance of their duties in an orderly manner and according to the required standards. When the offense is committed by more than one administrator, they are liable to the company in a solidary manner.
- 6) In particular, but without being limited to them, the administrator is obliged to compensate the company for the damages caused, if, contrary to the provisions of the law "On Entrepreneurs and Trading Companies", he performs the following actions:
- a) returns the contributions to the partners;
  - b) pays interests or dividends to partners;
  - c) the assets of the company are distributed;
  - d) allows the company to continue its commercial activity, when, based on the financial situation, it should have been foreseen that the company would not have the solvency to repay the obligations;
  - e) gives loans.

#### **KREU IV VITI FINANCIAR, EKSPERTËT**

#### **CHAPTER IV FINANCIAL YEAR, THE EXPERTS**

##### **Neni 16 Viti Financiar**

- 1) Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Article 16 Financial Year**

- 1) The financial year of the Company begins on January 1<sup>st</sup> and ends on December 31<sup>st</sup>. Exceptionally, the first financial year starts from the date of registration of the company in the National Business Center and ends on December 31<sup>st</sup>.

##### **Neni 17 Ekspertët**

- 1) Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtar të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tilla i ngarkuar nga ana e ortakut/ëve.
- 2) Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i

detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut/ëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**Article 17**  
**The Experts**

- 1) *The expert has the duty to check all the accounting documentation of the economic-commercial activity of the company, the annual and the periodic control exercised by him for the cases when he is charged and has performed such a thing charged by the part of shareholder/s.*
- 2) *At the end of the audit, the authorized accounting expert prepares a written report for the output of the annual financial balance as well as for the periodical audits performed, who is obliged to present and deliver it to the shareholder/s in time for review and approval on the basis of the decision-making right it has.*

**KREU V**  
**PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**CHAPTER V**  
**DISSOLUTION, REORGANIZATION OF THE COMPANY**

**Neni 18**  
**Prishja dhe likuidimi**

- 1) Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
  - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
  - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".
- 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.
- 5) Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Article 18**  
**Dissolution and liquidation**

- 1) *The dissolution or disruption of the company can be done at any time:*
  - a) *when the duration provided for in its establishment ends;*
  - b) *by decision of the Assembly of Shareholders;*
  - c) *with the opening of bankruptcy procedures;*
  - d) *if it has not performed commercial activity for two years and the suspension of activity has not been notified in accordance with the law;*
  - e) *by court decision;*
- 2) *In this case, the shareholders take a written decision in which they foresee the method of liquidation of the company, appointing one or several liquidators and marking in every document issued by him the name of the liquidator and the additional label "Company in liquidation".*
- 3) *The dissolution of the commercial company has as a consequence the initiation of the liquidation procedures in the state of solvency, unless it has initiated the bankruptcy procedure.*
- 4) *Liquidation is carried out by liquidators appointed by the Shareholders.*
- 5) *If the shareholders do not take a decision on the appointment of liquidators, within 30 days after the dissolution, any interested person can apply to the court to appoint a liquidator.*

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja**

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Article 19**  
**Reorganization of the Company, reunion, division**

- 1) *The company can be divided, united according to the Decision of the General Meeting of the Assembly of Shareholders, in accordance with the legal provisions provided in Part IX of Law 9901 dated 14.04.2012 "On Entrepreneurs and Commercial Companies."*

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Article 20**  
**Legal basis**

- 1) *The company will develop its activity in full compliance with this statute and the provisions of Albanian legislation.*
- 2) *To the extent not provided in this statute, the provisions of the law "On Entrepreneurs and Commercial Companies", the Civil Code and any other specific law in the Republic of Albania shall be applied.*

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**Article 21**  
**Disputes**

- 1) *All disputes that may arise will be resolved amicably, otherwise they will be resolved through special bodies recognized by law.*

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"FinanceTeams" sh.p.k**  
**SHAREHOLDERS OF "FinanceTeams" sh.p.k**

Thomas Johannes Petrus Hubert Van Wersch

Gaston Augustinus Gerardus Johannes Ploumen